

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL SH.A.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës të punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë publikon këtë:

K O N K U R S

Pozita: Inxhinier i Elektrikës

I përgjigjet: Menaxherit të Impiantit për Ujëra të Ndotura (ITUN) dhe Përgjegjesitë të sektorit të Pompave.

Ekzekutues: 2 (Dy)

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 muaj), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbështetje menaxhmentit të impiantit në menaxhimin e punëve të stafit dhe nën-kontraktuesve
- Sigurim që të gjitha informatat relevante (orari i punës së pompave, testet e funksionalitetit të pompave, valvulave dhe pajisjeve tjera, dëmeve, pengesave, zëvendësimeve të nevojshme) të jenë regjistruar si duhet.
- Mbështetje në planifikimin e mirëmbajtjes
- Mbështetje në planifikimin e furnizimit me materiale
- Zbatimi i rregullores mbi shëndetin dhe sigurinë në punë
- Mbështetje në përgatitjen dhe përdorimin e formularëve për punë të ndryshme
- Vlerësimi i gjendjes dhe performancës së aseteve mekanike
- Mbështetje në planifikimin e riparimeve, rehabilitimit dhe ndërrimeve
- Bën mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve dhe instrumenteve elektrike dhe elektronike

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- ❖ Diplomë universitare në fushën e elektrikës ose elektronikës
- ❖ Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- ❖ Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efektive nën presion;
- ❖ Të paktën 2 vjet përvojë pune në fushën elektronike
- ❖ Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetime;
- ❖ Dëshmi për përvojën e punës;
- ❖ Letër motivimin;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr. "Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web – faqen "Hidrodrini" Sh. A. www.hidrodrini.com.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU "Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. "Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës). Shpallja do të jetë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen www.hidrodrini.com

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e derguara pas afatit të cukur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU "Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.